



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 01.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P "ICN&BM", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga Lista Esenciale"- Lot 40 me Nr. të Prok: 206-23-4898-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik N.T.P "ICN&BM" e dt.28.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me barna nga Lista Esenciale"- Lot 40 me Nr. të Prok: 206-23-4898-1-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 27.07.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. Mbetet në fuqi, Njoftimit mbi Vendimin e AK, i publikuar me datë: 27.07.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P "ICN&BM", me datë 28.07.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga Lista Esenciale"- Lot 40 me Nr. të Prok: 206-23-4898-1-1-1. Autoriteti Kontraktues menjehere është marrë me shqyrtimin e kërkesës në fjalë dhe sot me datën 01.08.2023, vendosi si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkëlur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237 dhe konforme nenit 72. për plotësim dokumentacioni.

Dokumentet e kerkuara nga A.K. jane siguruar para se te behet shpallja publike e ketij aktiviteti te prokurimit me date 26.07.2023. Shpallja e njoftimit per tenderues te eliminuar eshte ber me 27.07.2023

Pretendimi ankimor

Me date 20.07.2023 Na eshte kerkuar dokumentacioni" Verteim nga gjykata ekonomike dhe vertetim Tatimor per biznesin ne fjale.

Per shkaqe teknike nuk kemi mundur qe deri me date 25.07.2023 ne ora 16.00 ti dergojme ne imelin e personit zyrtar.

Por qe me date 26.07.2023 i kemi siguruar dokumentet e kerkluar dhe te njejtat ja kemi derguar AK

Normalisht me vonese konforme rregullave te prokurimit.

Me qenese per ket lot nuk ka oferte tjeter dhe se jemi me oferte me qmim mete ulte se ai i parapare.

Kerkojme nga A.K Te shof mundesin ligjore nese lejohet qe te na pranohen dokumentat e kerkuar sepse perveq A.K qe do te duhet ta ritenderoj te njejtin produkt dhe ne si O.E qe do te duhet te procedojme prap me tenjejtat dokumente nuk demtohet askush.

Kerkojme te shiqohen mundesite qe te shpallemi fitues dhe te vazhdojme me tutje.

Dëmet materiale

Nuk është specifikuar ndonjë dem material.

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore te OE

AK-MSh i konsideron te pa bazuara pretendimet ankimore te OE ankues, duke marre parasysh se me datën 20.07.2023 kemi kërkuar te na i ofroni dokumentet/vërtetimet ne lidhje me Kërkesat e Përshtatshmërisë, me qëllimin qe tu shpallim fitues, duke i ofruar afat kohor prej 5 ditësh, qe deri me 25.07.2023 ne ora 16.00 qe ti ofrojnë vërtetimet e kërkuara.

OE ankues me datën 26.07.2023 i ka ofruar Vërtetimin e ATK dhe Vërtetimin nga Gjykata për kompaninë, por nuk e ka ofruar siç është kërkuar Vërtetimin qe pronari nuk është i dënuar.

Nuk qëndron deklarimi i OE ankues qe nuk ka pasur ofertues tjerë, meqenëse për këtë Lot 40, kemi pasur dy oferta dhe AK-MSh konform te drejtës qe i ofron LPP e kemi shpallur fitues ofertën e dytë ne radhë, ne vlerën e ofertës 16,100.00 euro.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. N.T.P "ICN&BM"
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit